



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM

Nr 32 Datë 13-06-2007

PËR
**NDRYSHIM DESTINACONI TË FONDIT TË SHFAQJES "ALLEGRETTO
ALBANIA" APROVUAR ME V.K.B. NR 2 DT. 02.02.2007**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës për « NDRYSHIM DESTINACONI TË FONDIT TË SHFAQJES "ALLEGRETTO ALBANIA" APROVUAR ME V.K.B. NR 2 DT. 02.02.2007 », bazuar në ligjin nr. 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, pika "dh", Udhëzimin nr 2 dt 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr 2 dt.02.02.2007 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007» mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e destinacionit të fondit prej 280.000 lekë të shfaqjes « Allegretto Albania ».
2. Fondi prej 280.000 lekë të kalojë për shfaqjen « Sokaku i të marrëve ».
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Kulturës, Drejtoria e Financës pranë Bashkisë, si dhe institucioni i Teatrit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda Nase
Raimonda Nase